

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6925
E hënë, 19 qershor 2023
Çmimi 0.40

Departamenti Amerikan
i Shtetit i bën thirrje
Vuçiqit t'i lirojë pa kushte
tre policët e Kosovës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com



TRAGJEDI NË LUMIN LEPENC | PAGE 4-5

HUMBJE E MADHE PËR FAMILJEN PACOLLI, NXIRREN NGA LEPENCI TRUPAT E PAJETË TË TRE FAMILJARËVE



Njësitë speciale të policisë maqedonase dhe të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë nxjerrë të dielën nga lumi Lepenc makinën me trupat e pajetë të tre të shtetasve të Kosovës, e cila të shtunën kishte

rënë në lumë pas një aksidenti me një automjet tjetër. Aksidenti ndodhi afër Shkupit, disa kilometra larg vendkalimit kufitar mes dy shteteve, në Blacë. Në veturën me targa të Kosovës ishin katër persona.

Shkëlqimi i cili i mbijetoi këtyri aksidenti, humbi prindërit dhe vëllanë. Familjes Pacolli i kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të institucioneve të Kosovës, liderë partish dhe qytetarë të shumtë

AKTUALE



BLINKEN SHKON NË KINË
PËR T'I STABILIZUAR RAPORTET
DYPALËSHE F. 2

NYT: PROVAT SUGJEROJNË SE
RUSIA SHKATËRROI DIGËN NË
UKRAINË F. 2

NATO-ja: PO I MARRIM SHUMË
SERIOZISHT NGJARJET
NË VERI TË KOSOVËS F. 5

EKONOMI



A DO TË SHITREN JTOHEN MALLRAT
PAS NDALIMIT TË ATYRE SERBE? F. 7

MURATI MOHON SE
ËSHTË ZVOGËLUAR NUMRI
I TË PUNËSUARVE F. 7

SPORT



KOSOVA SONTE KËRKON FITOREN
E PARË NË KUALIFIKUESIT
PËR "EURO 2024" F. 10

'KUFIRI I
INCIDENTEVE'
NË MES TË
KOSOVËS DHE
SERBIË F. 4-5



KEQPËRCEPTIMI
FILOZOFIK
USHOEN POLITIKA
DESTRUKTIVE F. 6

Shkruan: Dr. Hajdin ABAZI



RENOVA
PUTZ
Kallmeti
Zhangjellë - Yllendi
Gardë - Përfaqë
E-mail: renovant.net.mk
Tel: +386 44 407 232 | +386 44 407 233
+386 44 407 755
Fax: +386 44 407 230
080-077 41 001 289

PRINCESHA
NDERTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ll.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
020 500 070 | 045 500 070
045 500 070 | 049 500 070

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SHËNJA INTERNACIONALE YËNËSHËRIMIT SHËNJA INTERNACIONALE
Shërbime: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj
Fax: +381 30 308 242 | 307 514 | +381 30 308 246 302
E-mail: info@sigma.rs.net | www.sigma.rs.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NYT: Provat sugjerojnë se Rusia shkatërroi digën në Ukrainë

NYU-JORK, 18 QERSHOR - Provat sugjerojnë se shkatërrimi i digës Kahovka në zonën e kontrolluar nga rusët në Ukrainë është shkatërruar nga një shpërthim i brendshëm që është detonuar nga Rusia, ka raportuar "New York Times".


Duke cituar inxhinierët dhe ekspertët e ekspozitëve, gazeta amerikane tha se hetimi ka gjetur prova që sugjerojnë se pajisja shpërthyes ishte vendosur në një vendkalim në digë, ku dhe u detonua, duke shkatërruar digën më 6 qershor. "Provat qartazi sugjerojnë se diga u shkatërrua nga shpërthimi që u krye nga pala që e kontrollon atë Rusia", tha NYT.

Një ekip ekspertësh ligjorë ndërkombëtarë, që u kanë ndihmuar prokurorëve ukrainas në hetimin e tyre, thanë se gjetjet

paraprake sugjerojnë se "ka shumë të ngjarë" që shembja e digës në rajonin ukrainas të Heronit është shkatërruar nga ekspozitë e vendosur nga rusët.

Kremlini e akuzon Kievin se ka sabotuar digën hidroelektronike, që kishte një rezervuar të madh të ujit, për ta ndërprerë burimin kryq të ujit për Krimenë - që Rusia ka aneksuar paligjshëm nga Ukraina më 2014 - dhe për ta shpërnduar vëmendjen nga kundërofensiva e saj "e dështuar" ndaj forcave ruse.

Ukraina e akuzon Rusinë se e ka hedhur në erë digën e epokës sovjetike që është nën kontrollin rus që në ditët e para të pushtimit, që Moskë nisi më 2022, duke shkatërruar përmblytje të mëdha, duke shkatërruar toka bujqësore dhe duke ndërprerë furnizimet me ujë për civilët.



NYT citoi inxhinierët të kenë thënë se një ekzaminim i plotë i digës pas tërheqjes së ujit mund të përcaktojë se si rrodhën ngjarjet që çuan në shkatërrimin

e saj. "Erozioni nga uji që kalon nëpër portat mund të kishte çuar në një dështim nëse diga do të ishte projektuar keq, ose nëse betoni i vendosur në të do të

ishte nën standardet e kërkuara. Por, inxhinierët thanë se kjo ishte e pamundur që të ketë shkatërrim shkatërrim e digës, raportoi NYT.

Izraeli kundërshton çdo marrëveshje të përkohshme për programin bërthamor të Iranit

Jerusalem, 18 qershor - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, tha të dielën se kundërshton çdo marrëveshje të përkohshme, që po raportohet se po negocohet mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, lidhur me programin bërthamor të Teheranit.

Netanyahu i bëri këto deklaratat pas mediet në Izrael raportuan se ka mirëkuptim midis Uashingtonit dhe Teheranit se do të synojnë ta frenojnë deri në një masë programin bërthamor të Iranit, në këmbim të lehtësimit të disa sanksioneve. Këto raportime nuk kanë mundur të



konfirmohen në mënyrë të pavarur dhe ShBA-ja publikisht ka mohuar një marrëveshje të këtij lloji. Netanyahu tha se Izraeli e ka informuar ShBA-në se

"dakordimet më të kufizuara, ato që quhen 'mini-marrëveshje', për mendimin tonë, nuk i shërbejnë qëllimit dhe ne jemi kundër marrëveshjeve të tilla". Zyrtarët izraelitë besojnë se

tashmë janë arritur mirëkuptime për kufizimin e pasurimit të uranimit dhe disa fonde të ngjira veçse janë zhbllokuar.

Portali izraelit "Walla" javën e kaluar raportoi se janë arritur disa mirëkuptime që Irani ta kufizojë pasurimin e uranimit deri në 60 për qind në këmbim të lehtësimit të sanksioneve. Kjo mëdha, po ashtu, të pas palët po diskutojnë për lirin e të burgosurve. Javën e kaluar zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, tha se "nuk ka marrëveshje", duke shtuar se këto raportime ishin të pavërteta.

Më 2018 ShBA-ja është tërhequr nga marrëveshja e vitit 2015 midis Iranit dhe fuqive botërore që synonte frenimin e programit bërthamor të Teheranit në këmbim të lehtësimit të sanksioneve.

Irani thotë se programi i tij bërthamor ka qëllime civile. Por, Izraeli e konsideron Iranin si një kërcënim të madh bërthamor, që kërkon shkatërrimin e Izraelit dhe mbështet grupet anti-Izrael në mbarrë rajonin.

Izraeli nuk e përjashton mundësinë e veprimit ushtarak për ta parandaluar Iranin që të posedojë armë bërthamore.

Blinkeni shkon në Kinë për t'i stabilizuar raportet dypalëshe

PEKIN, 18 QERSHOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka nisur vizitën në Kinë dhe është takuar me homologun e tij kinez, Qin Gang. Blinken do të qëndrojë në Kinë për dy ditë për të zhvilluar bisedime me zyrtarët kinezë. Kjo është vizita e parë e një diplomati amerikan në Kinë në pothuajse pesë vjet.

Zyrtarët amerikanë thanë se qëllimi kryesor i bisedimeve është stabilizimi i raporteve me Kinën që janë bërë ekstremisht të tensionuara. Blinken para pesë muajsh e kishte shpirtë këtë vizitë, pas fluturimit të një balone të dyshuar kineze të spjelmazhit në hapësirën ajrore amerikane.


ShBA-ja ka ulur prijet për këtë vizitë dhe dyja palët e kanë bërë

të qartë se nuk presin ndonjë rezultat të madh.

Qëllimi, thanë zyrtarët amerikanë, është rihapja e bishave të komunikimit në nivel të lartë dhe stabilizimi i raporteve, që janë përqendruar pas incidentit me balonën.

Kina ka mbajtur stërvitje ushtarake pranë Tajvanit, që Pekini e sheh si pjesë integrale të Kinës. ShBA-ja mban raporte të ngushta me Qeverinë tajvaneze të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Sipas agjendës, përveç me kryediplomatën kinezë, Blinken do të takohet edhe me zyrarët për politikë të jashtme Wang Yi. Lufta në Ukrainë, mosmarrëveshjetë tregtare lidhur me teknologjinë e avancuar kompjuterike dhe të drejtat e



njeriut në Kinë janë pjesë e temave që Blinken pritet t'i diskutojë me zyrtarët në Pekin.

Zyrtarët kinezë që kanë reaguar ndaj vizitës së Blinkenit kanë vënë

në pikëpyetje nëse ShBA-ja është e sinqerë në përpjekjet e saj për t'i përmirësuar raportet.

Është ende e paqartë nëse Blinken do të takohet me presidentin kinez

Xi Jinping.

Blinken është zyrtar më i lartë amerikan që viziton Kinën qëkur presidenti amerikan, Joe Biden, mori detyrën në janar të vitit 2021.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

TRAGJEDI NË LUMIN LEPENC

Humbje e madhe për familjen Pacolli, nxirren nga Lepenci trupat e pajetë të tre familjarëve

Njësitë speciale të policisë maqedonase dhe të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë nxjerrë të dielën nga lumi Lepenc makinën me trupat e pajetë të tre të shtetasve të Kosovës, e cila të shtunën kishte rënë në lumë pas një aksidenti me një automjet tjetër. Aksidenti ndodhi afër Shkupit, disa kilometra larg vendkalimit kufitar mes dy shteteve, në Blacë. Në veturën me targa të Kosovës ishin katër persona. Shkëlqimi i cili i mbijetoi këtij aksidenti humbi prindërit dhe vëllanë. Familjes Pacolli i kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të institucioneve të Kosovës, liderë partish dhe qytetarë të shumtë

Faton DËRMAKU

Preservim, 18 qershor - Njësitë speciale të policisë maqedonase dhe të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë nxjerrë të dielën nga lumi Lepenc makinën me trupat e pajetë të tre të shtetasve të Kosovës, e cila të shtunën kishte rënë në lumë pas një aksidenti me një automjet tjetër. Aksidenti ndodhi afër Shkupit, disa kilometra larg vendkalimit kufitar mes dy shteteve, në Blacë. Zyrtarët policorë të Njësisë Speciale Amëteroriste kanë gjetur të vdekur tre personat të cilët po kërkoheshin në lumë pas aksidentit të shtunën në rrugën Shkup - Blacë. Është gjetur edhe automjeti BMW në të cilin ndodheshin personat, tashmë të vdekur, thuhet në njoftimin e MPB-së.

Në veturën me targa të Kosovës ishin katër persona dhe njëri prej tyre ka arritur të dalë prej saj, ndërsa të tjerët së bashku me mjetin ranë në lumin Lepenc. Personi është nxjerrë nga lumi dhe është transferuar në spitalin '8 Shtatori' në Shkup dhe është në gjendje të mirë shëndetësore, ka njoftuar policia maqedonase.

Autoritetet maqedonase më herët gjatë 18 qershorit njoftuan se kanë ndaluar shoferin e automjetit me targa të Shkupit, që i aksidentua me makinën me targa të Kosovës. "Sektori i punëve të brendshme në Shkup po vazhdon hetimet lidhur me incidentin në rrugën Shkup-vendkalimi kufitar Blacë dhe me urdhrë të prokurorit publik, drejtesja e automjetit Volkswagen Turan, me inicialet B. B., është ndaluar për hetime të mëtejme", thuhet njoftimin e MPB-së.



Në momentin e aksidentit, sipas policisë maqedonase, ka pasur prurje të mëdha të lumit Lepenc për shkak të reshjeve të rëmbeshme të shiut.

Në operacionin e nxjerrjes së makinës kanë marrë pjesë edhe ekipe të kërkim-shpëtimit nga Kosova. Në vendin e ngjarjes dolën edhe ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Florian Qehaja, së bashku me ministrin e Brendshëm, Xhelal Sveçla.

Kryeministri Albin Kurti ka reaguar lidhur me aksidentin që ka ndodhur të shtunën mbrëmë në lumin Lepenc në Shkup, ku kanë humbur jetën tre qytetarë të Kosovës.

"Sapo u njoftova nga autoritetet tona se vetura e aksidentuar mbrëmë dhe e rënë në lumin Lepenc në Shkup është gjetur dhe në të janë trupat e pajetë të tre qytetarëve tanë. Shkëlqimi, i cili i mbijetoi këtij aksidenti, i uroj shërim sa më të shpejtë e forcë për ta përballuar dhimbjen e humbjes së prindërve e vëllait të tij. Shpreh ngushëllimet e mia më të singerta për familjen Pacolli dhe Visoka të cilët humbën familjarët e tyre. Ngjarje të tilla si kjo prekin thellë secilin prej nesh. Falënderoj përzemësisht ekipet tona profesionale të PSK-së, Policisë së Kosovës, vullnetarët e kërkim-shpëtimit dhe autoritetet e Republikës së Maqedonisë së

Veriut të cilët, në bashkëpunim të ngushtë, që nga momenti kritik, kanë bërë maksimumin e tyre për kundër të gjitha sidave me të cilat janë ballafaquar", ka theksuar Kurti.

Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se lajmi për humbjen e tre anëtarëve të familjes Pacolli na ka mërzitur shumë të gjithëve. "Lajmi për humbjen e tre anëtarëve të familjes Pacolli në aksidentin e ndodhur mbrëmë afër Shkupit na ka mërzitur shumë të gjithëve. Në këto momente të rënda u shpreh ngushëllimet më të thella familjeve Pacolli dhe Visoka, posaçërisht Shkëlqimit, i cili pati fatin t'i shpëttojë kësaj tragjedie, në të cilën humbi prindërit dhe

vëllanë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Për këtë lajm të trishtë për ndarjen tragjike nga jeta të tre anëtarëve të familjes Pacolli ka reaguar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "E rëndë të shohësh raste të tilla ku shuhen familje e jetë njerëzish! Ngushëllime familjes Pacolli dhe gjithë atyre që i njohën. Të mbijetuarit nga ky rast i uroj shërim të shpejtë!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

"Viktimat e familjes Pacolli, të prehen në paqe në atdhe. Ngushëllimet e mia më të singerta familjarëve! Një tragjedi që na prek të gjithëve!", ka shkruar në "Facebook" lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli.

Departamenti Amerikan i Shtetit i bën thirrje Vuçiqit t'i lirojë pa kushte tre policët e Kosovës



Preservim, 18 qershor - Departamenti Amerikan i Shtetit i ka bërë thirrje presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe Qeverisë serbe, që t'i lirojë "menjëherë dhe pa kushte" tre policët e Kosovës të arrestuar më 14 qershor. "I bëjmë thirrje presidentit Vuçiq dhe Qeverisë së Serbisë që menjëherë dhe pa kushte të lirojë tre policët e Kosovës të arrestuar më 14 qershor. Arrestimi dhe ndalimi i tyre i vazhdueshëm për akuzat të rreme ka përkeqësuar një

situatë tashmë të tensionuar. Ne, gjithashtu, vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Serbisë dhe Kosovës që ta ndjekin planin trepikësh të përshkruar nga BE-ja dhe të kthehen pa vonesë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja", thuhet në komunikatën për medie të DASH-it.

Serbia ka thënë se tre policët e Kosovës janë arrestuar "thellë brenda territorit" të saj, por Kosova e ka quajtur rënimin këtë veprim nga forcat serbe dhe ka thënë se ata ishin në territorin e Kosovës.

'Kufiri i incidenteve' në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRESENË, 19 QERSHOR - Kosova dhe Serbia ndajnë një vijë kufitare të gjatë rreth 350 kilometra. Që 24 vjet pas përfundimit të luftës në këtë vijë kufitare, që për Kosovën është kufi e për Serbinë vijë administrative, kanë ndodhur disa incidente.

Një ka ndodhur në vitin 2012, kur njësitet speciale të Serbisë kanë arrestuar dy policë kufitare të Kosovës në fshatin Dumnice të Podujevës.

Një incident i ngjashëm ka ndodhur edhe më 14 qershor të këtij viti, kur forcat serbe kanë arrestuar tre policë të Kosovës. Kosova thotë se ata janë arrestuar në territorin e saj. Serbia pretendon në të sasin, ndërsa misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, thotë se "mbetet e paqartë" se ku kanë qenë policët në kohën e arrestimit.

Në fakt, në të dy rastet Serbia ka pretenduar se policët e Kosovës kanë hyrë në territorin e saj dhe se ata nuk kanë të drejtë të shkelin në atë që njihet si "zonë neutrale". Sipas palës serbe, në zonën neutrale në mes të Kosovës dhe Serbisë të drejtë patrullimi kanë vetëm pjesëtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe forcat serbe. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka fajësuar Serbinë për, siç ka thënë, "rënjbimim" të tre policëve në territorin e Kosovës.

Si kontrollohet vijën kufitare Kosovë - Serbi?

Kosova dhe Serbia zyrtarisht nuk e kanë të kryer procesin e demarkacionit të kufirit. Megjithatë, kur është bërë demarkacioni me Malin e Zi në vitin 2018 - me gjithë kundërshtimet politike në Prishtinë - si referencë është marrë Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, që është miratuar më 28 shkurt të vitit 1974 - asokohe nga ana e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe Kuvendit të Jugosllavisë. Me këtë dokument Kosova ka pasur kufijtë e saj territoriale që kanë pasur cilësinë e kufijve shtetërorë.

Për sigurinë e kufijve të territorit të Kosovës, nga viti 1999 kur ka përfunduar lufta, është përgjegjës misioni i KFOR-it. Ky mision e ka këtë përgjegjësi bazuar në atë që njihet si Marrëveshje Ushtrako-Teknike e Kumanovës, e cila ka dhënë fund luftës në Kosovë. Serbia e ka nënshkruar këtë marrëveshje me NATO-n në vitin 1999, duke i tërhequr më pas të gjitha forcat policore dhe ushtarake nga Kosova.

As KFOR-i e as autoritetet e Kosovës nuk kanë folur për REL-in lidhur me mënyrën e menaxhimit të zonës neutrale në mes të Kosovës dhe Serbisë.



Harta: Lendi Susuri, Google Earth / Landsat / Copernicus

Cfarë thotë Marrëveshja e Kumanovës?

Për të vendosur një ndërprerje të qëndrueshme të armiqsisë, në asnjë rrethanë, asnjë Forcë e RFJ-së [Republikës Federative të Jugosllavisë] dhe Republikës së Serbisë nuk do të hyjë, rihyjë ose mbetet brenda territorit të Kosovës ose Zonës së Sigurisë Tokësore dhe Zonës së Sigurisë Ajrore.

Më 2012 dhe 2023, kur Serbia ka arrestuar policë të Kosovës, ajo ka thënë se ata kanë shkelur Marrëveshjen Ushtrako-Teknike

të Kumanovës, e cila, sipas Beogradit zyrtar, nu mundëson patrullim të armatosur në "zonën e neutrale" vetëm forcave të KFOR-it dhe forcave të Serbisë.

Por, të njëjtën gjë e ka thënë vazhdimisht edhe Prishtina zyrtare. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Serbia ka shkelur Marrëveshjen e Kumanovës që e ndalon çdo forcë policore e ushtarake serbe të futet në territorin e Kosovës.

Policia e Kosovës kryen patrullime në vijën kufitare Kosovë - Serbi që nga themelimi i saj më 1999.

Në vitet e para të pastafutës patrullimit janë kryer në bashkëpunim me KFOR-in, misionin e Kombeve të Bashkuara, UNMIK, më vonë edhe me misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, institucionet ndërkombëtare, si KFOR-i dhe EULEX-i, i kanë transferuar gradualisht përgjegjësitë për kontrollin e zonës neutrale Kosovë - Serbi - që është rreth 5 kilometra - te Policia e Kosovës.

Tani policia kryen patrullime të rregullta në vijën kufitare me Serbinë njëjtë si me shtetet e tjera.

Incidentet kryesore në vijën kufitare Kosovë - Serbi

Incidenti i fundit është arrestimi i tre policëve kufitare të Kosovës - sipas autoriteteve të vendit - në Tresave/Bare në Leposaviq, pjesa veriore e Kosovës. Kosova ka parashitë hartë të vendit ku, siç është thënë, kanë qenë policët - rreth 1.5 kilometra brenda

territorit të Kosovës, ndërkohë që, sipas Serbisë, ata janë arrestuar "thelë" në territorin e saj.

KFOR-i, si përgjegjësi kryesor për sigurinë e territorit të Kosovës, ka thënë më 16 qershor se "bazuar në të dhënat e disponueshme, mbetet e paqartë se ku kanë qenë zyrtarët e Policisë së Kosovës në momentin e arrestimit".

Po atë ditë Prokuroria e Lartë në Kralëvë - qytet në jug të Serbisë - ka dhënë urdhër për kryerjen e hetimeve ndaj tre policëve të Kosovës dhe u ka shquptuar masë paraburgimit prej 30 ditësh.

Sipas autoriteteve serbe, ata dyshohet se kanë kryer veprën penale: prodhim, posedim, mbajtje dhe trafikim i paligjshëm i armëve dhe lëndëve plasëse, e cila bart dënimin deri në 12 vjet burg. Derisa kanë qenë duke patrulluar në vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë, më 31 mars të vitit 2012, dy policë kufitare të Kosovës janë arrestuar nga xhandarmëria serbe në fshatin Dumnicë të Podujevës.

Serbia edhe asokohe ka thënë se policët e Kosovës kanë hyrë ilegjisht në "zonën neutrale", ku, sipas institucioneve atje, është e ndaluar me Marrëveshjen e Kumanovës.

Policët janë liruar pas kalimit të masës së ndalimit prej 48-orësh.

Incidenti i vitit 2011 për kontrollin e pjkave kufitare

Në korrik të vitit 2011 Qeveria e Kosovës ka organizuar një aksion për marrjen e kontrollit të pjkave kufitare i dhe 31 në janinë dhe Bërnjak - pjesa veriore e Kosovës - të cilat ishin dëgjur nga grupe serbë qësh në vitin 2008, si shumëlindim nga shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Qindra automjete të Policisë së

Kosovës janë bllokuar nga serbët lokalë, që kanë barrikaduar rrugët drejt Bërnjakut dhe Janinës. Në këtë aksion është vrarë polici i Kosovës, Enver Zymeri, një persona ende të padejnuar.

Që nga ajo kohë policët dhe doganierët të Kosovës janë vendosur në këto dy pika kufitare.

Rasti i Karaçevës

Banorët e fshatit Karaçevë në komunën e Kamenicës - pjesa lindore e Kosovës - që nga përfundimi i luftës kanë reaguar vazhdimisht për, siç kanë thënë, fytjen e xhandarmërisë serbe në territorin e Kosovës.

Hera e fundit kur janë publikuar fotografi që forcave serbe në atë që është thënë se është brenda territorit të Kosovës, ka qenë më 20 mars 2020.

"Terrorizmi i banorëve të Karaçevës nga forcat serbe është i papranueshëm dhe për këtë duhet të bartin përgjegjësi edhe forcat e KFOR-it. Ajo zonë është përcaktuar si zonë neutrale (edhe pse gjuhësisht dhe e vetmja forcë që ka të drejtë hyrjeje në atë zonë është KFOR-i", ka thënë Qëndron Kastri, asokohe kryetar i Kamenicës.

Përgjatë viteve ka pasur dhjetëra incidente të natyrave të ngjashme.

Për demarkacionin e kufirit s'është folur asnjëherë

Kosova dhe Serbia janë në bisedime, herë për çështje teknike e herë për politike, që nga vitit 2011. Megjithatë, çështja e demarkacionit të kufirit në është diskutuar drejtpërdrejt asnjëherë.

Dy vendet kanë arritur Marrëveshjen për Menaxhimin e Integruar të Kufirit më 2 dhjetor



Harta: Lendi Susuri, Google Earth / Landsat / Copernicus

2011. Përmes kësaj marrëveshjeje, Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të krijojnë pika të përbashkëta kufitare në vendkalimet kufitare: Merdar, Bërnjak, Mutivodë,

Janinë, Dheu i Bardhë dhe Maçlabë. Një tije shprehe në këtë drejtim e ofron Marrëveshja e Bruselit, e arritur në mes të Kosovës dhe

Serbisë në shkurt, e përmes së cilit, palet, mes të tjerash, obligohen të njohin dhe respektojnë tërësinë territoriale të njera-tjetra.

NATO-ja: Po i marrim shumë seriozisht ngjarjet në veri të Kosovës

Prishtinë, 18 qershor - NATO tha se po ndërmerr të gjitha hapat për të ofruar mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes në veri të Kosovës. Zëdhënësjja e NATO-s, Oana Lungescu, shtoi se misioni i aleancës ushtarake perëndimore në Kosovë, KFOR, merr "shumë seriozisht" ngjarjet në veri të Kosovës. "Zbatimi i mandatit të tij nga KFOR është i palëkundur, sic e dëshmohet edhe me dislokimin e 500 trupave shtesë. Ne edhe një herë ua kujtojmë të gjitha palëve obligimet e tyre sipas Marrëveshjes Ushtarako-Teknike, përfishirë respektimin e vijës kufitare administrative, procedurave për Policinë e Kosovës dhe marrëveshjen e vitit 2013 për dislokimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në veri. Këto obligime janë dizajnuar për të siguruar veprim të koordinuar, për të shmangur shkallëzimin, për të ruajtur dhe siguruar mjedis të sigurt", u tha në reagimin e NATO-s. Sipas Marrëveshjes Ushtarako-

Teknike të Kosovës, që i dha fund luftës në Kosovë, KFOR-i është përgjegjësi për sigurinë e kufijve të territorit të Kosovës. Më 14 qershor, në zonën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë, janë arrestuar tre policë kufitarë të Kosovës nga forcat serbe. Serbia pretendon se ata janë arrestuar "thelë" brenda territorit të saj, por Kosova thotë se ata janë rëmbyer brenda territorit të Kosovës. KFOR-i, si përgjegjësi kryesor për sigurinë e territorit të Kosovës, ka thënë më 16 qershor se "bazuar në të dhënat e disponueshme, mbetet e paqartë se ku kanë qenë zyrtarët e Policisë së Kosovës në momentin e arrestimit". Ndaj tre policëve të Kosovës një gjykatë në Kralëvë ka shquptuar masën e paraburgimit prej 30 ditësh. Departamenti amerikan i Shtetit në një deklaratë të përbashkët të 11 llojë menjëherë policët e Kosovës që, sipas Uashingtonit, po mbahen në paraburgim nën



akuza të pabaza. Rasti i tre policëve të Kosovës vjen një kohë e rritjes së tensioneve në verin e Kosovës, të banuar me shumicë serbe. Serbët në këtë zonë po

protestojnë që nga 26 maj, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, hyrë në ndërtesat komonale me asistimin e Policisë së Kosovës. Tensionet kulman më 29 maj,

kur në shqiptar protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Nga përleshjet janë lënduar dhjetëra persona nga të dyja palët.

Keqperceptimi filozofik ushqen politika destruktive

Shkruan: Dr. Hajdin ABAZI

Kam shkruar më parë se gjithçka që e ka mbërthë Kosova, në këto tri dekadat e fundit, e ka bërë vetëm kur është bashkërenduar ngushtë me ShBA-në, që nënkuptonte: me tërë spektrin euroatlantik.

Kjo ka qenë linja politike se si është vepruar nga ana e liderëve të Kosovës. Përjashtim ka bërë, nga fillimi, vetëm Albini Kurti. Ai me kursin e tij të ekstremit gjodjapatritiotik, së arriti të indoktrinonte një masë të rinjsh, falë edhe indiferencës së partive politike nga viti 2005 e këndej. Nënçmimi i keqperceptimit filozofik nga klasat politike por edhe nga mediat, tash po i jep frytë e hidhura.

Ideologjitë ekstreme janë indoktrinimi më i thellë dhe më i rrezikshëm që ekzistojnë, sepse i ushqejnë individët me keqperceptime përmes të cilave ata pastaj e shohin botën në mënyrë të shtrembër: raportet shoqërore, politiken, partneritetet.

Më kujtohet që shumica e liderëve e shihnin si një "cun që rebelohet për t'u shquar" dhe e nënvizonin qasjen e tij ekstreme, duke besuar se është e pamundur që ai të ketë sukses me veprimet antiamerikane. Besonin se për secilin shqiptar është i qartë përcaktimi përëndimor dhe euroatlantik. Po dëshmohet se një lider që ka dioptri të mbrapshtë filozofike, mund të mashtronte masat e gjera. E ka dëshnuar historia në të kaluarën edhe të popuj të tjerë. Dhe Kurti ia arriti: mori pak më shumë se 50% të elektoratit, edhe për shkak të korruptsionit, nepotizmit të cilat tha se do t'i luftojë e në fakt i bëri publike, duke i "legjitimuar". Për më tepër, çfarë bëri me këtë besim të qytetarëve?

Nisi të protagonizohet duke eskutuar nga partneri jetik i Kosovës: ShBA, duke bërë veprime kundërshtuese, neglizhuese, sovranilëse, qartazi me frymën "shpërfillse". Një patriot i vërtetë në pushtet do të shquante linjën e mundësisë politike dhe do ta drejtonte shtetin kaq përfitimt, për konsolidim dhe forcim partneritetesh, për të siguruar paqen e brendshme, stabilitetin



dhe zhvillimin. Qasja absurde shkoi deri aty sa duket se gjithçka që ka qenë Hashim Thaçi për, duhet t'i dilet kundër! Edhe partneriteti euroatlantik në krye me ShBA-në. Duhet ngjyrosur anti-Kosovë! Kurti duket se e ka mprehur shpatën e ndryshkur nga koha, për t'u sulur partnerëve, duke goditur ShBA-në, pastaj Bashkimin Evropian dhe së fundi edhe NATO-n përmes KFOR-it. I vetëm kundër të gjithëve. Duket sikur njëneurotik, që hidhet kundër familjes së vet!

Atë që është munduar me dekada ta bëjë Serbia, po e bën kjo qeveri. Dihet ajo thënia e Dobrica Cosiqit se shërbimi serb duhet të punojë për ta futur frymën antiamerikane të shqiptarët, sepse vetëm ashtu i

vjen shansi Serbisë. Ende po me duket si një delir imi, e jo si një realitet që Kurti po e hedh kundër Kosovës partneritetin përëndimor. Duke u nisur nga aspekti i linjës klasore dhe ideologjisë majtiste të cilën e njoh thellësisht, e kujtoj Kurtin: kështu ai bëhet një hero i lëvizjes së majtë ekstreme në botë për kundërvënien ndaj "forcave imperialiste". Por ai harron se këtë po e bën në dëm thuajse të pariparueshëm për Kosovën. Një ditë Kurti do të shkojë nga pushteti, por dëmi i shkakutur do të mbetet dëm për Kosovën.

Po noterja e Kurtit, ajo që e mban postin e presidentes, është shushatur. Ajo po mërmëritë diçka. Por fjalët tashmë janë doktra, noter! Përëndimi do

ndërrim të qasjes filozofike dhe të vetë kursit politik - heqje dorë nga anti-euroatlantizmi dhe anti-amerikanizmi! Si dhe, sinkronizim me gjeopolitiken euroatlantike! Jo veprime në shërbim të gjeopolitikës rusosërbe!

Vendet mike duan një qeveri bashkëpunuese me partnerët. Këtë e tha qartë ambasadori gjerman në Kosovës, që është një distancim i hapur ndaj politikës së qeverisë aktuale. Dhe Eskobar e tha shkoqur: kush nuk do partneritet, duhet të presë pasoja (një zbutje e fjalës sanksione). Ndoshta ndokujt mund t'i duket "ndershëmri" prishja me partnerët euroatlantike, pa të cilët ekzistenca shtetërore e Kosovës as që mund të mendohet me një Serbi prusore, me ushtri të rregullt

e aviancion, si dhe konfliktshkaktuese.

Kurti me disa veprime arriti t'i fusë KFOR-in në veprim, dhe filloi të besojë se KFOR-i mund të veprojë sa herë që Qeveria e njohtë para aktit të kryer! E tash Kurti befasohet se përse KFOR-i po hesht e nuk po e njofton atë! Partneriteti nuk vlen vetëm kur ti do, por kur edhe partnerët duan, është një raport i ndergjellë.

Duket se ka humbur sensi etatist i shtetarëve kurtian: ministria e Drejtësisë e karrikaturon KFOR-in në mënyrë sarkastike! Harron se ajo është ministrie dhe ka përgjegjësi shtetërore!

Tash është krijuar një atmosferë për forcat kriminale dhe ekstreme në pjesën veriore, sa thuaja po veprojnë hapur. Madje, po i ndjekin gazetarët e kameramanët dhe po i rrahin! Kur shihen këto pamje, secili ka të detyrë të pyes: Zoti Kurti, ku është sovraniteti? Ku është ligji? Si ndodhka që nën qeverisjen tënde bandat kriminale ditën po i ndjekin shqiptarët në veri?

Uroj ta kesh kuptuar se pa partneritet me ShBA-në dhe vendet euroatlantike as ligji e as sovraniteti nuk qëndrojnë në këtë pjesë të Ballkanit!

Prejse erdhi në pushtet në vitin 2021, Kurti vetëm më kuraz, goditje politike, shkakime, kundërshtim i hapur me ShBA-në, e tash edhe me BE-në dhe KFOR-in! Ku po e çon Kosovën kështu, kryeministër?

Vetëm një verbëri ideologjike, prapa së cilës mund të fshihet gjithçka e errët dhe e dymshët, mundet ta bëjë një politikan si Kurti, të quajë navi sekretarin e shtetit amerikan Blinken!

Diplomacinë e Kosovës e keni shtrirë për tokë, e keni bërë mjernane, e keni paralizuar, nga se qëndrimet tuaja u ngafuan diplomatikisht.

E tash, çka? Çka më tutje?

Nëse ende mund të shpëtohet diçka, kjo mund të bëhet duke braktisur menjëherë kursin anti-ShBA, anti-BE dhe anti-KFOR. Të rrikohet falje publike. Të rikthehet veprimi për partneritet. Sepse, ashtu sikurse kam shkruar para një viti, Kosovës i dëm mirë vetëm me bashkërendim me ShBA-në, e tash është me BE-në dhe me KFOR-in. Ndryshe, fundoset Kosova!
(Autori është ish-ambasador)

Hoti: Muaji i katërt që policët nuk i marrin shtesat e rrezikshmërisë në punë

PRISHITIN, 18 QERSHOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se që katër muaj policët nuk i marrin shtesat e rrezikshmërisë në punë. "Ky është muaji i katërt që policët

nuk i marrin shtesat e rrezikshmërisë në punë. Vonesa për një muaj do të ishte e kuptueshme, pasi duhet futur të dhënat në sistemin e Thesarit në Ministrinë e Financave. Por të mos paguhen për katër muaj

tregon mungesën e vullnetit dhe përpjegjësinë ndaj policëve që dërgohen çdo ditë në veri, si dhe ndaj familjeve të tyre që çdo ditë janë të shqetësuar kur i përcjellin për punë", ka shkruar Hoti në "Facebook".



A do të shtrenjtohen mallrat pas ndalimit të atyre serbe?



PRESHËNË, 18 QERSHOR - Autoritetet përgjegjëse në Kosovë zotohen se do t'i rritin angazhimet për përcjelljen e tregut në mënyrë që të parandalohet rritja eventuale e çmimeve të mallrave pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndalimin e hyrjes së mallrave serbe në vend.

Vendimi për ndalimin e mallrave serbe është marrë më 15 qershor pas arrestimit të tre policëve të Kosovës nga forcat serbe. Kryeministri Albin Kurti e cilësoi ndalesën e mallrave si masë të sigurisë, dhe jo ekonomike apo tregtare. Për arsye të ndryshme, Kosova edhe në të kaluarën ka marrë masa kufizuese kundër prodhimeve serbe, të cilat janë ndër më të pranishmet në tregun vendor, gjë që ka rezultuar pastaj me rritje të çmimeve të mallrave. E pyetur nga REL-i se çfarë masash do të ndërmarret për parandalimin e rritjes eventuale të çmimeve të mallrave, Ministria

e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë thotë: "Kur ka qasje apo dukuri që kërkojnë fokus dhe angazhim më të madh, rritet numri i inspekteve, punojmë me orar të zgjatur dhe jemi të angazhuar edhe gjatë ditëve të fundjavës. Inspektorati i Tregut do ta monitorojë tregun dhe në rast se konstatohet çfarëdo shkeljeje të dispozitave ligjore në fuqi, do të ndërmerren masa ndëshkuese", thuhet në deklaratë. Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në rast se gjendet ndonjë parregullsi gjatë monitorimit, gjohet sillen nga 1 000 deri në 4 000 euro.

Nga Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës pohojnë për REL-in se pas rrethanave të krijuara, "do të fokusohen te kontrollit e çmimeve të produkteve bazë - miellit, grurit, vajit, sheqerit, qumështit". Serbia është ndër vendet me praninë më të madhe të

produkteve, qoftë ushqimore apo edhe të tjera, në Kosovë. Brenda një dite ky shtet eksporton mallra në Kosovë në vlerë një milion euro. Me rritje të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, Kosova është përballur që nga fundi i vitit 2021, kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Hov, pastaj, ka dhënë edhe pushtimi rus i Ukrainës, i cili ka nisur në fund të shkurtit 2022. Vitin e kaluar Kosova e ka përmblytur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind.

Situata mund të ndryshojë në afat të gjatë

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Luzim Rafuna, beson se në një periudhë afatshkurtesë bizneset nuk do t'i lëvizin çmimet e produkteve, "mirëpo nëse

bizneset detyrohen që lëndën e parë, që e kanë blerë në rajon, në këtë rast në Serbi, ta sjellin nga Kina apo nga ndonjë vend i largët, kjo do ta risë kostot e lëndës së parë dhe do të ndikojë në çmime. Jo me vullnetin apo dëshirën e prodhuesit dhe të importuesve tanë, sepse edhe këta kur ta prodhojnë produktin final dhe kur ta shesin në tregun evropian, do të jenë më të shtrenjtë", thotë Rafuna. Ngjashëm shpreh edhe Arben Terëshajku, menaxher në kompaninë "Liri" në Prizren, e cila merret me prodhimin e produkteve të ndryshme ushqimore. "Çmimet e produkteve nuk rriten vetëm me një lëvizje. Fabrika 'Liri' rrit çmimet vetëm në rastet kur ka lëvizje të kostove. Ne nuk kemi lëndë të parë që e marrim nga Serbia", thotë ai për Radion Evropë a Lirë. Kompania "Pestova" në Vushtri merret me përpunimin dhe

prodhimin e patates. Pronari i saj, Bedri Pestova, zotohet se në rast të rritjes së kërkesës për prodhimet e tyre, çmimet e tyre nuk do të ndryshojnë. Në dhjetor të vitit 2022 fushata "Mos bli prodhime serbe" u bë virale në rrjetet sociale në Kosovë. Megjithatë, atë muaj importi i prodhimeve nga Serbia kapi vlerën e më shumë se 30 milionë eurove. Kur në fund të vitit 2018 Qeveria e Kosovës vendosi taksë, fillimisht 10 % e më pas 100 % mbi produktet e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, rritja e çmimeve të produkteve në tregun e Kosovës nisi të vërehet gradualisht. Këtë muaj pas vendosjes së taksës, e cila ka mbetur në fuqi për më shumë se një vit, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës kanë treguar se shkalla e inflacionit është rritur - në mars të vitit 2019 ka qenë 3.3 për qind në vitin 2019 me muajin mars të vitit 2018.

Murati mohon se është zvogëluar numri i të punësuarve

PRESHËNË, 18 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transferëve, Hekuran Murati, ka demantuar mediet të cilat të dielën raportuan se numri i të papunëve në Kosovë është zvogëluar për 30 mijë në vitin 2023. Ministri Murati ka thënë se kjo informatë nuk është e saktë. Sipas tij, në muajin prill

të këtij viti janë të deklaruar rreth 7 000 punëtorë në shumë sеса në tremujorin e parë të vitit paraparak. "Autori ka bërë krahasim të vendeve të përgjithshme të punës në TM1 2022, me të punësuarit që kanë punë primare në prill 2023. Përndryshe, informata e saktë sipas raportit të fundit të

ATK-së është se, për muajin prill 2023 janë të deklaruar 395,166 të punësuar, apo rreth 7 mijë më shumë sеса TM1 2022 - nëse duam t'i krahasojmë indikatorët ashtu si duhet", ka shkruar Murati në "Facebook". Në fund ai ka thënë se "lajmet e rreme nuk kalojnë".



Pyjet tropikale të Amazonës: Çuditë më të paeksploruara të botës së egër në Tokë



Nga Helen PILCHER

Pylli tropikal i Amazonës është pylli tropikal më i madh që ka mbetur aktualisht në botë. Po ashtu, ai është pylli me biodiversitetin më të madh. I në 10 nga të gjitha specieet e njohura jetojnë këtu atje, përfshirë shumë prej tyre që janë të rrezikuara dhe nuk gjenden askund tjetër.

Amazona është e madh, e bukur, dhe është shumë e rëndësishme, jo vetëm sepse thihet sasi të mëdha karboni, por ndikon tek modelet e reshjeve në të gjithë Amerikën e Jugut dhe ndikon mbi klimën e tyre. Gjatë 40 viteve të fundit, rreth një e pesta e pyjeve të shiut është prerë ose djegur, për t'i hapur rrugë fermave të bagëtive dhe aktivitetëve të tjera.

Tani shkencëtarët kanë frikë se është në prag të një dëmi të pariparueshëm. Në duhet të veprojim tani për të shpëtuar një nga mrekullitë e fundit të vërteta të botës. Duke u shtrirë në 9 vende, përfshirë Brazilin, Perunë dhe Kolumbinë, pylli tropikal i Amazonës zë një sipërfaqe prej 5.5 milionë kilometra katrorë.

Më pak se gjysma e kësaj zone është e mbrojtur. Lumi Amazon, që e përshkon atë mes për mes, rrjedh për më shumë se 6500 km. Ai është lumi i dytë më i gjatë në botë pas Nilit, dhe shkarkon rreth 15 për qind të ujrave të lumenjve të planetit në oqean.

Njerëzit kanë jetuar në Amazonë për të paktën 10,000 vite e fundit. Kolonët e lashtë kultivuan pemë vendase si arrën braziliane,

palmën maripa dhe pemën e kakao. Me kalimin e kohës kjo ndikoi në përberjen e pyjeve tropikale. Kur evropianët e parë mbërritën në Amerikën e Jugut në fund të shekullit XV-të, aty jetojnë rreth 6.8 milionë njerëz indigjenë. Kolonistët bartinin sëmundje infektive, si malaria dhe gripit, që vranë miliona amazonianë. Mijëra të tjerë u skllavëruan ose u zhvendosën. Sot, në rajonin e Amazonës jetojnë rreth 30 milionë njerëz, nga të cilët 2.7 milionë janë indigjenë, që përfaqësojnë më shumë se 350 grupe të ndryshme etnike.

Shumica jetojnë në rezervate indigjene të njohura si 'resguardos', ku stili i tyre i jetesës përfshin një përzierje të elementeve tradicionale dhe përditërore. Megjithatë, rreth 60 fise jetojnë në izolim vullnetar dhe i përmbahen kryesisht mënyrave të puvuara dhe të sprovuara të paradhënieve të tyre.

Në Amazonë gjenden të paktën 10 për qind të biodiversitetit të njohur në botë. Aty jetojnë më shumë se 1000 lloje të ndryshme zogjsh, mbi 500 lloje zvarranikësh, përfshirë amonokardat e gjelbra, dhe më shumë se 400 lloje amfibesh, duke përfshirë zhabën gjigante dhe brektoën tepër helmuese. Po ashtu, jetojnë është më shumë se 300 lloje gitarësh. Lumi Amazona përmban rreth 3000 lloje peshqish të ujrave të ëmbla, më shumë se çdo sistem jetorë lumor. Një në pesë lloje peshqish jetojnë këtu. Vlerësohet se jetojnë rreth 2.5 milionë lloje insektesh. Në vetëm një pemë të këtyj pylli, më shumë të ketë më shumë lloje

miliongash, sesa në disa vende. Të mos harrojmë dhe jetën bimore. Pylli tropikal përmban rreth 80,000 specie bimore, përfshirë 390 miliardë pemë të rreth 16,000 llojeve. Por sa i vjetër është ky pyll? Askush nuk e di me siguri. Disa mendojnë se pylli tropikal i Amazonës nisi të formohet gjatë Eocenit, rreth 55 milionë vjet më parë, pasi temperaturat u ulën dhe Oqeani Atlantik u zgjerua mjaftueshëm për t'i garantuar rajonit një klimë të ngrohtë dhe të lagësht.

Disa ekspertë mendojnë se kjo nodochi më vonë, rreth 15 milionë vjet më parë, pasi pllakat tektonike të Amerikës së Jugut dhe Nazka u thyen me njëra-tjetrën për të formuar Andet, duke krijuar një liqen të madh me ujë të ëmblë që mbuloi pellgun e Amazonës. Më pas pati disa epoka akullnjore, dhe uji lloji të rrjedhë nga Andet në oqean. Kështu lindi lumi Amazona. Sedimentet nga malet u derdhën në pellgun e Amazonës, duke krijuar tokat e nevojshme për rritjen e pyjeve të shiut.

Studiues të tjerë mendojnë se ai është më i ri. Një studim sugjeron se 1/5 e pellgut të Amazonës mund të kishte qenë barishte, derisa një zhvendosje natyrore në një klimë më të lagësht rreth 2000 vjet më parë, nxiti rritjen e më shumë pemëve.

Çdo specie që jeton atje është e rëndësishme, jo vetëm në vetvetë, por sepse luan një rol të rëndësishëm në ekosistemin më të gjërë. Ka grabitqarë, pastures, shpërfaqësues, farash,

dekompozues dhe pjalmsue, për të përmendur vetëm disa. Atë ofrojnë burime jetike për njerëzit indigjenë që ende jetojnë këtu, si dhe një rezervuar zgjidhës të mundshme për problemet në shkallë globale. Zbulimi i frumuesh ACE, të cilët tani përdoren në mënyrë rutinore për trajtimin e presionit të lartë të gjakut, u frymëzua nga studimet e nepërkës helmuese braziliane. Pylli tropikal i Amazonës nganjëherë quhet "mushkërrë e Tokës" sepse thihet dioksid karboni dhe nxjerr oksigjen në një shkallë masive.

Rreth 123 miliardë tonë karbon është sekuestruar në pyjet dhe tokat e Amazonës. Avujt e ujit të lëshuar nga pylli krijojnë "lumenj fluturues" të mëdhenj në qiell, duke ndikuar në sistemet e motit afër dhe larg. Deri në 50 për qind të reshjeve në Amazonë vijnë nga vetë pylli. Por ai shkakton shi deri në një të Argentinës, ku ndihmon në mbështetjen e bujqësisë.

Por dekadat e fundit, pyjet e shiutna po priten për t'i hapur rrugë fermave të bagëtive dhe plantacioneve të sojës dhe kulturave të tjera. Ndryshimet klimatike, minierat, prillimi i lëndës drusore dhe zhvillimi i rrugëve, shtëpija dhe infrastrukturës tjetër, po kontribuojnë gjithashtu në shkatërrimin e tij.

Më shumë se 18 për qind e pyjeve tropikale të Amazonës janë shkatërruar deri më tani, dhe 17 për qind të tjera janë të degraduara. Ndërsa po zhduken habitatet e tyre, shumë lloje, si luani i artë tamarin dhe tapiri i

Amerikës së Jugut, po shkojnë drejt zhdukjes.

Një studim i vitit 2021, zbuloi se çdo vit, pyjet e shiut tani lëshojnë rreth 1 miliardë ton dioksid karboni më shumë se sa mund të thithin. Pra një "lavaman jetik" i karbonit po kthehet në një emetues karboni. Ndaj shkatërimi i pyjeve tropikale të Amazonës po nxiri ndryshimet klimatike, dhe shkencëtarët kanë frikë se është pranë një pike kthesë, përtej së cilës nuk do të jetë në gjendje të gënjerojë reshjet e veta dhe të mbështesë ekosistemet e saj.

Ecaj nëpër pyjet e dendura dhe të paprekura nuk është e lehtë, ndaj pjesë të pyllit tropikal të Amazonës mbeten të pa-eksploruara. Askush nuk e di saktësisht se sa mbetet e pa-eksploruar, por teknologjia po i ndihmon studiuesit që t'i studiojnë këto zona.

Shkencëtarët fluturuan mbi to duke përdorur një lazer për të hartuar tokën. Muzet dhe publikuar vitin e kaluar, zbuluan praninë e dy vendbanimeve të lashta, të kompletuara me piramidë kornike, ndërtesa prej balte dhe terraco artificiale, të rrethuara nga një rrjet rrugësh të ngritura. Shkencëtarët mendojnë se mund të ketë shumë qytete të tjera të humbura që presin të zbulohen.

Sipas një studimi të pyjeve të shiut në tre kontinente, tokës i duhen rreth 10 vjet për të rifituar biodiversitetin origjinal të bimëve, kafshëve u duhen rreth 60 vjet ndërsa biomasa e përgjithshme kërkon rreth 120 vit. /

"Science Focus" - Bota.al

Natalie Portman: Qenieve njerëzore duhet t'u rrëfohen histori



Nga Gregorio BELINCHÓN

Në vitin 1996, marrëdhënia midis Mary Kay Letourneau, një mësuese 34-vjeçare në një shkollë në Seattle, SHBA, e cila ishte e martuar dhe kishte 4 fëmijë, dhe e nxënësit të saj 12-vjeçar, Vili Fualaau, me prejardhje samoane, bëri bujë në mbarë botën.

Skandalin shpërtheu kur Letourneau mbeti shtatzënë, dhe kur u zbulua se të dy ishin në një marrëdhënie seksuale. Burri i Letourneau u divorcua nga ajo dhe i mori me vete 4 fëmijët e tyre në Alaskë. Ky veprim shkaktoi një zinxhir ngjarjesh: prindërit e Vili Fualaau e paditën mësuesen dhe u zhvillua një gjyq.

Dënimi ishte i lehtë – vetëm 3 muaj burg – por do të ishte më i ashpër nëse Letourneau takohet sërish me nxënësin e saj. Pasi lindi një vajzë, ajo përfundoi vuajtjen e dënimit dhe doli nga burgu. Por një mëngjes në shkurtin e vitit 1998, policia e zbuloi atë me nxënësin e saj brenda një makinë.

Një muaj më vonë, ajo njoftoi se ishte sërish shtatzënë. U dënua me 7 vjet e gjysmë burg dhe lindi në qeli vajzën e dytë me Fualaau. Mary nuk doli nga burgu deri në vitin 2004. Ajo përpqoi që të anulonte urdhrin që e pengonte atë të shihte Fualaau, dhe vitin e

ardhshëm, të dy u martuan feshëruazi.

Në vitin 2018, një dokumentar konfirmoi se ata po divorcoheshin. Letourneau u diagnostikua me kancer dhe Fualaau i qëndroi pranë deri në vdekjen e saj në moshën 58 vjeçare në korrik 2020. Kjo ngjarje dramatike ishte një ushqim për tabloidët dhe televizionet që merren me lajmet rozë.

Kjo histori ka depërtuar në kinema falë filmit "May December", me regjinë e Todd Haynes, që garoi në Festivalin e 76-të të Filmit në Kanë. Në film protagoniste janë aktoria Julianne Moore si Gracie Atherton-Yoo, personazhi i frymëzuar nga Letourneau dhe Natalie Portman, e cila luan rolin e Elizabeth Berry, një aktore fituese e Çmimit Oscar, e cila dëshiron të mësojë më shumë mbi Gracie në përgatitjen e një filmi për jetën e saj.

Kur Berry takon Gracie, ajo punon me kohë të pjesshme në një dyqan kafshësh në Savannah. Për Natalie Portman, May December, është një film shumë i veçantë: është filmi i parë i realizuar nga kompania e saj MountainA, dhe ishte ajo që me skenarin në dorë kërkoi për regjisorin e duhur.

"Më shkoj menjëherë mendja për Todd, për shkak të aftësisë së tij për të portretizuar jetën e

njerëzve të periferive" – tha ajo në konferencën për shtyp. Nga ana tjetër, Todd froi Julianne Moore për të luajtur rolin e një gruaje të lidhur në mënyrë romantike me një djalë (në këtë version, ai ka prindër koreanë) 23 vjet më të ri.

"Todd ishte zgjedhja ime e parë, një ëndë. Dhe kur ai e bindi Julianne, e çoi një hap më tej ëndërrën time" – shtoi Portman duke buzëqeshur. Ajo vetë debutoi në kinema në vitin 1994, duke luajtur rolin e një vajze me një marrëdhënie komplekse me një vrasës në "Leon: The Professional".

"May December" fokusohet sa në marrëdhënien romantike po aq sa edhe në marrëdhënien midis aktore dhe personazhit që do të luajë. "Roli im, është një mundësi që ne të gjithë të analizojmë nëse arti mund të jetë amoral. Sa filma janë bërë për vrasës serialë, sa vrasje shohim në ekran, pa bërë një gjymim vlerash?" – pyeti ajo.

Dhe ky refleksim ndodh pikërisht në personazhi moralisht të dyshimtë të luajtur nga Portman. Me një përzierje komedie të errët, skenash të trazuar dhe një atmosferë të televizionit, May December, e ritregon historinë famëkeqe.

"Unë kam qenë aktorë për ndëgjim të madhe të jetës sime, ndaj e kam kërkuar këtë rol për gjithë ato vite. Ajo që është magjepsëse

tek personazhi, është se ajo nuk e ka problem të aktojë gjatë gjithë kohës, dhe është e gatshme të shkojë shumë larg për të arritur synimet e saj, madje edhe kur mbetet vetëm" – thekson aktoria. Për Portman, imazhi i aktorëve si parazitë që shfrytëzojnë emocionet e njerëzve të tjerë për t'i dhënë jetë punës së tyre është një kishë e pavërtetë. "Krijimi i jetëve të tjera në teatër apo kinema, është për mua një akt dashurie dhe dhembshurie dhe sigurtisht një gjëzim" – thekson ajo. Gjatë pandemisë, Portman e pranon se ishte e shqetësuar për të ardhmen e saj profesionale: "Unë e kam bërë këtë punë për kaq shumë vite, dhe kam parë ndryshimin rrethor të kësaj industrie. Nuk e humba shpresën se do të aktojë sërish pas përfundimit të bllokimit. Duke qenë se jemi qenie njerëzore, kemi nevojë që të na rrëfohen histori reale".

Në filmin "May December", personazhi i Portman mban një fjalim në një kurs teatri ku merr pjesë fëmija më i vogël i Gracie. Gjatë bisedës, ajo rrëfen se skenat e seksit janë sa të bezdisshme aq sa edhe magjepsëse, dhe se ndonjëherë mund të rrimbehet nga kësaj që ka me kolektë e saj.

"Është një moment që bie në sy në skenar. Ne të gjithë kemi ndjenja të vërteta për qeniet e

tjera njerëzore. Dhe kjo ndodh si në aktrim ashtu edhe në jetën reale. Ju duhet të dini se si ta menaxhoni atë, dhe të mos e ngatëroni punën me emocionet. Në rastin tim, unë nuk jam ndjerë kurrë rehat me skenat e seksit" – shprehet ajo. Një sfidë tjetër interesante e skenarit, thotë Portman, ishte të tregonte një grua që kryente një krim që zakonisht burrat e kryejnë kundër grave. "Ky kapërcim psikologjik është i jashtëzakonshëm".

Dhe kjo ndodh sepse ne nuk i kemi parë kurrë të gjitha versionet e mundshme të grave në ekran. Për mua, kjo do të ishte arritja e barazisë. Mund të jemi njerëz të ligj, atëherë, budallenj të zgjuar, kompleksë... Sa më shumë larmi, aq më mirë" – nënvizon Natalie.

Si pjesë e aktivizimit të saj si feministe, Portman është një nga themelueset e një ekupi profesionist të futbollit për femra në Los Anxhelos. "Për disa kohë, më pëlqen të bëj gjëra më të rezhikshme, si ky film. Unë kam dekada të tëra që aktoj, dhe tani që kam kaluar tek produksioni, kam zbuluar sfida të tjera...por edhe vështirësi të tjera. Këtë herë gjithçka ka rrethodhur si duhet, dhe shpresoj të vijdësh gjithë këtu edhe për një kohë të gjatë" – përfundoi aktoria. / "El Pais" – Bota.al

EURO GLASS

BEKURIT PULEGURIT

Adri: Fushë Kosovë
 Moby: 046 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@five.com



Spanja, fituese e Ligës së Kombeve

ROTTERDAM, 18 QERSHOR - Pas 120 minutave lojë dhe goditjes së 12 penaltive, "iberikët" spanjollë të udhëhequr nga tekniku Luis de la Fuente janë shpallur për herë të

parë në historinë e tyre, kampionë të Ligës së Kombeve. Gjithçka u vendos nga Dani Carvajal, i cili shënoi penaltinë decisive pas 2 gatave kroate të

Lovro Majer e Bruno Petković, duke shtuar një tjetër trofe të rëndësishëm evropian në listën e gjatë të "la furia roja". Kështu falë këtij triumfi, Spanja u bë ekipi i 3-

të në histori që fiton këtë trofe, teksa kujtojmë se edicioni i parë u fitua nga Portugalia e Cristiano Ronaldo dhe i dyti nga "igjetat" francezë të Kylian Mbappe.



Kosova sonte kërkon fitoren e parë në kualifikueset për 'Euro 2024'

Pas tri barazimeve në tri ndeshjet e para kualifikuese për Kampionatin Evropian, Kosova sonte kërkon fitoren e parë në ndeshjen ndaj Bjellorusisë, e cila zhvillohet në Hungari. Optimist për fitore janë shprehur edhe në konferencë për medie përzgjedhësi Alain Gresse dhe futbollisti Betim Fazliji



Veton ZYMBERI

PRASHITJE, 18 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka zhvilluar të dielën përgatitjen e fundit para ndeshjes kualifikuese për Kampionatin Evropian kundër Bjellorusisë, e cila zhvillohet sonte (e hënë) në Budapest nga ora 20:45. "Dardanët" janë paralizimëruar se luftojnë për fitore në këtë ndeshje, pasi deri tash ende nuk e kanë shijuar fitoren në kualifikime dhe në tri ndeshjet e zhvilluara kanë barazuar në tri ndeshjet. Përzgjedhësi i Kosovës, Alain Gresse në konferencë për medie ka deklaruar se e kanë analizuar lojën e bjellorusëve dhe se do të mundohet ta dominojë lojën dhe të marrin pikët maksimale. "E kemi analizuar lojën e Bjellorusisë,

siç besoj se edhe ata e kanë studiuar lojën tonë. Në veçanti e kemi analizuar ndeshjen e tyre të fundit kundër Izraelit. Sidoqoftë, ne nuk do t'i përshtatem lojës së tyre por do t'u imponojmë atyre lojën tonë, pasi qëllimi ynë është ta dominojmë këtë ndeshje. Kundër Rumanisë kemi bërë lojë të mirë, por ka munguar finalizimi i rasteve", ka thënë Gresse, duke shtuar se: "Nuk më pëlqen të flasë tani për ndeshjet e kaluara, por them se kemi bërë futboll të mirë, veçmas në ndeshjen e fundit, ku na mungoi vetëm goli. Prandaj, na duhet të luftojmë më shumë për ta gjetur rrugën e golit dhe të arrijmë deri te fitorja". I pranishëm për në konferencën për medie ishte edhe futbollisti Betim Fazliji, i cili ka deklaruar se "dardanët" në Budapest kanë ardhur për ta

realizuar fitoren e parë në këto kualifikuese. "E dëmë çfarë rëndësie ka kjo ndeshje. Do ta japim maksimumin dhe presim t'i marrim me vete pikët e plota.

Kemi ende gjasa të mëdha për t'u kualifikuar. Duhet të shprehim kënaqësi për lojë. Qëllimi është t'i marrim pikët e plota ndaj Bjellorusisë", ka thënë

Fazliji. Ndeshja mes Bjellorusisë dhe Kosovës zhvillohet nga ora 20:45, kurse është ndeshja e katërt për "dardanët" në kualifikueset "Euro 2024".

Kosova U21 e gatshme të përballet me Estoninë



PRASHITJE, 18 QERSHOR - Energji pozitive po vazhdon të mbretërojë në Përfaqësuesen e Kosovës U21. "Dardanët" e rinj, si asnjëherë tjetër por përgatitjen që të shënojnë rezultat pozitiv në ndeshjen e parë kualifikuese që e zhvillojnë kundër Estonisë, të martën, në stadiumin "Facil Vokri". Kosova U21 e ka ekipin e kompletuar i cili përbëhet nga futbollistë vendor dhe ata të ardhur nga skuadrat

evropiane, të cilët janë komponuar dhe përgatitur mirë për të shënuar fitore në ndeshjen e parë drejt Evropianit 2024. Përgatitjet e deritashme kanë shkuar për së mbari dhe si tregdhije, përzgjedhësi Afrim Tovërlani ka bindje të mira për takimin e 20 qershorit. Ai pas stërvitjes e ka thënë se problemi i vetëm ka qenë moti jo i mirë por kjo nuk i ka penguar të realizonjë të gjitha përgatitjet e tyre dhe

shpreson që të martën përveç punës dhe përkushtimit të kenë edhe fatin në anën e tyre. Nga ana tjetër Besfort Zeneli pohoi se atmosfera është shumë e mirë dhe se do të japin maksimumin kundër Estonisë. Emik Bruti kërkoi përkrahjen e "Dardanëve", teksa theksoi se në "Facil Vokri" do të luajnë për fitore. Kosova U21-Estonia U21 zhvillohet të martën nga ora 20:00, derisa hyrja për të gjithë tifozët do të jetë falas.

Llapi rikthen Namanin

PODRIJE, 18 QERSHOR - Skuadra e Llapiit e ka rikthyer në skuadër ish-kapitein Hamdi Namanin, i cili ishte pjesë e Dritës për katër vite me radhë. Namanin ishte futbollist iky i formacionit bazë të gilanasve në Superligë dhe në

gara ndërkombëtare, kurse tash mësuesori në fjalë do të vësh fanellën e klubit ku u rrit si futbollist. "Marrëveshja me Lumën është arritur mbretërnë, ku në pranë të presidentit të klubit, Beqir Batatina. 'Lumi' ka

nënshkruar kontratë për edicionin 2023/24. 'Lumi' do të jetë forcë shtesë e ekipit tonë për stinorin e ri pasi që kualiteti dhe angazhimi i tij nuk ka nevojë për shumë koment. Rikthimi i 'Lumi' dhe futbollistëve të rinj

që do i zyrtarizojmë ditëve në vijim na bënë të besojmë në arritjen e objektivave e që sigurisht janë trofetë. Mirë se rikthehesh 'Lumi', guri i rëndë peshon në vend të veti", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapiit.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Fundao Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Dbi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

